



EDUKIMI MJEDISOR



Prill 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë çarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

**“E vetmja rrugë nëse do të përmirësojmë cilësinë e mjedisit,
është përfshirja e të gjithëve”**

Richard Rogers

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 **Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **prill 2024**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **740**

37 Shkolla të përfshira

Mësues të përfshirë **37**

20 Specialistë të angazhuar

Orë mjedisore të realizuara **37**



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR

22



22 prill 2024, Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të "Ditës Botërore të Ligatinave" u zhvillua një orë e hapur mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare "Gjergj Vat Martini" Velipojë, përgjatë së cilës u diskutua mbi ligatinat dhe rëndësinë e këtyre ekosistemeve të veçanta. Ora e hapur mjedisore u zhvillua pranë Qendrës së Vizitorëve në Velipojë, pjesë e PUTM Lumi Buna – Velipojë dhe territoreve ligatinore përreth saj. Më pas, të gjithë së bashku zhvilluam një vizitë në zonën ligatinore Këneta e Gjerdafit si dhe vrojtimi i shpendëve pranë kullës së vrojtimit.

planeti Tokë

përkujdesje dhe mbrojtje

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



18 prill 2024, njohim monumentet e natyrës

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat, stafi i AdZM-së Kukës organizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Shkinak” brenda Parkut Natyror “Korab-Koritnik”. Qëllimi ishte njohja me vlerat natyrore të zonës, në veçanti me monumentet e natyrës si dhe rëndësia e ruajtjes së tyre. Nxënësit u njohën në parim me vlerat natyrore të zonës, rëndësinë e ruajtjes së faunës së egër, si dhe rëndësinë e zbatimit të rregullave dhe respektimit të legjislacionit për kujdesin ndaj natyrës.

22 prill 2024, Dita e Tokës

Në kuadër të Ditës së Tokës, AdZM Kukës së bashku me Klubin e Ambasadorëve të Natyrës, pjesë e Qendrës për Progres Rinor, realizuan një orë mjedisore dhe një aksion pastrimi pranë Monumentit të Natyrës “Këneta e Kukësit”. Është e rëndësishme që të gjithë të kuptojmë dhe reflektojmë përmes veprimeve tona - Toka dhe biodiversiteti kanë nevojë çdo ditë për dashurinë dhe përkujdesjen tonë.

26 prill 2024, njohim biodiversitetin e PK Alpet e Shqipërisë

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat, stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Ali Podrimja” në Bajram Currë. Nxënësit u njohën me biodiversitetin e larmishëm që ka Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”, shtrirjen gjeografike si edhe historikun mbi shpalljen e tij si Zonë e Mbrojtur, kategori e II. Në përfundim nxënësit u udhëzuan mbi rëndësinë e kujdesit që duhet të tregojnë gjatë eksplorimeve dhe aktiviteteve të ndryshme në natyrë.

vlerat natyrore

monumentet e natyrës

aksion pastrimi

zonë e mbrojtura, kategoria e II





3 prill 2024, Dita Botërore e Kafshëve Ujore

Stafi i AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës së mesme të përgjithshme “Ishull Lezhë” vizituan subjektin e peshkimit në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Kune-Vain-Tale”. Atyre iu prezantua bota nënujore, llojet e specieve që jetojnë si dhe problematikat me të cilat kjo botë përballet. Peshkatarët e këtij subjekti i treguan më tepër rreth periudhave të peshkimit, mënyrat e menaxhimit të peshkimit në lagunë dhe mjetet tradicionale të peshkimit, informacione të cilat nxënësit i dëgjuan me shumë vëmendje dhe interes.

8 prill 2024, Dita Botërore e Shëndetit

Specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Nikë Tome Prela” Gorre zhvilluan një orë mjedisore me temë “Mjedis i pastër, jetë e shëndetshme”. Shëndeti i mirë kërkon një mjedis të pastër dhe harmonizimin ndërmjet faktorëve fizik, psikologjik, social dhe estetik. Së bashku me fëmijët zhvilluam pyetësor në lidhje me temën duke i nxitur ata të mendojnë më tepër dhe të jenë të ndërgjegjësuar për rëndësinë e shëndetit të gjallesave në Tokë.

22 prill 2024, Dita e Tokës

Në kuadër të Ditës së Tokës stafi AdZM Lezhë ka zhvilluar një aktivitet pastrimi në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Kune-Vain-Tale” së bashku me nxënësit e shkollës së mesme të përgjithshme “Ishull – Lezhë” dhe shoqatën Eco Albania. Kjo veprimtari shërbeu për ndërgjegjësimin e brezave të rinj, të cilët duhet të kujdesen për mjedisin duke mos e ndotur atë, si edhe të kontribuojnë për pastrimin e tij në rastet e nevojshme.

bota nënujore

pajisje peshkimi

shëndeti i gjallesave



05 prill 2024, ekspeditë në Bovillë

Ekspertët e AdZM-së Durrës mundësuan një ekspeditë në zonën e Bovillës, pjesë e PK “Mali i Dajtit”, së bashku me nxënësit e klasës së 10-të, të gjimnazit “Mustafa Myrteza Kaçaçi”. Nxënësit u njohën me ZM Bovillë dhe zonat e mbrojtura në tërësi; për rëndësinë dhe tipologjinë që ato kanë në mjedis dhe shëndetin tonë. Më pas me nxënësit përshkruam shtegun “Diga Bovillë – Shpella e Gamtit”. Me ndihmën e nxënësve shënjuam shtegun, i cili i përket një niveli mesatar të vështirësisë. Në fund të aktivitetit së bashku mbollëm 50 fidanë akacie në Bovillë, duke kontribuar kështu për pyjet, mjedisin dhe shëndetin tonë

11 prill 2024, nxënësit krijojnë herbarium

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Mustafa Myrteza Kaçaçi” janë njohur për herë të parë me metodologjinë e krijimit të një herbariumi. Specialistët e AdZM-së Durrës siguruan që nxënësit të fitonin disa njohuri të përgjithshme mbi larmishmërinë e florës që gjendet në Parkun Natyror “Qafështamë” dhe më pas rreth hapave që duhet të ndjekin për krijimin e një herbariumi. Duke ndjekur udhëzimet e dhëna, nxënësit u treguan të gatshëm dhe mjaft bashkëpunues në zhvillimin e veprimtarisë. Në përfundim çdo nxënës krijoi herbariumin e tij duke specifikuar llojin e bimës, familjen dhe vendndodhjen. Krijimi i herbariumit ka rëndësi pasi ndihmon për të njohur florën lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ata ruajnë ekzemplarë të bimëve endemike që rrezikojnë të zhduken. Herbariumi është një prej formave të edukimit për larminë dhe rëndësinë e bimëve.

22 prill 2024, Dita e Tokës

Nxënësit e klasës së 6-të të shkollës “Rinia” Durrës, u njohën me temën dhe rëndësinë e kësaj dite përmes një leksioni informues nga specialistët e AdZM-së Durrës. Dita e Tokës është dita e përgjegjësisë kolektive, për të promovuar harmoninë me natyrën dhe Tokën; për të arritur një ekuilibër të drejtë midis nevojave ekonomike, sociale dhe mjedisore të brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm. Motoja e kësaj dite për këtë vit është “planeti kundër plastikës”. Ishte bukur teksa shihje nxënësit kur interpretonin posterat e krijuar dhe qasjen e tyre në diskutimin e hapur për pyetësinorin e zhvilluar. Energjia e tyre ishte e dukshme dhe në aksionin e pastrimit të mjediseve brenda shkollës.

ekspeditë mjedisi dhe shëndeti shënjim shtegu

herbarium dita e Tokës

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



09 prill 2024, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Bahri Nela” Zall Bastar ishte destinacioni i radhës ku specialistët e AdZM-së Tiranë zhvilluan një orë mjedisore. Ata u njohën me termin ndotje, llojet e ndotjes, problemet që sjell ndotja në shëndetin e njeriut dhe organizmave të tjerë. Gjatë bashkëbisedimit me specialistët, nxënësit mësuam se cilët janë disa prej faktorëve që çojnë në shtimin e ndotjes. Nëpërmjet ushtrimit dhe pyetjeve të drejtuara nxënësve, dëgjuam prej tyre ide të ndryshme mbi minimizimin e ndotjes dhe pasojave që ajo shkakton. Në fund të orës mjedisore, me entuziazimin që i karakterizon, nxënësit përcollën mesazhet e tyre për kujdesin e mjedisve në tokë-ujë-ajër.

18 prill 2024, Dita Botërore e Trashëgimisë

Në shkollën 9-vjeçare “Helmas” u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët e AdZM-së Tiranë në kuadër të Ditës Botërore të Trashëgimisë. Nxënësve iu dha informacion mbi karakteristikat dhe vlerat e veçanta të monumenteve të natyrës. Gjithashtu ata kuptuan që këto monumente natyre të ruajtura dhe të mirëmbajtura luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit, pasi turistët shfaqin interes për t'i njohur dhe vizituar nga afër. Nëpërmjet kësaj ore mjedisore ne synuam të ndërjegjësojmë të rinjtë për monumentet e natyrës, të cilët janë një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kombëtare.

22 prill 2024, Dita Botërore e Tokës

Nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Vesel Tila” pjesë e Parkut Natyror “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh” u njohën më simbolikën dhe qëllimin e Ditës Botërore të Tokës. Nxënësit u informuan rreth historisë së krijimit të Tokës, periudhave më kulminante të shndërrimit të saj si dhe me problematikat mjedisore që përballet sot planeti. Në përfundim të orës mjedisore, nxënësit nëpërmjet mesazheve dhe vizatimeve treguan dashurinë që ata kanë për natyrën.

ndotje

pasojat në shëndet

trashëgimi kombëtare



“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



8 prill 2024, kuptojmë përmes eksperimenteve

Specialistët e AdZM-së Berat zhvilluan një orë edukimi për mjedisin në bashkëpunim me shoqatën Eco Albania dhe nxënësit e klasës së 8-të, shkolla 9-vjeçare "Mehmet Qyprii" Roshnik. Gjatë saj u diskutua për ruajtjen e mjedisit dhe mënyrat e jetesës që kanë pasoja negative në natyrë. Për të kuptuar më mirë konceptin u realizua një eksperiment. Përmes një tullumbace që lëviz përgjatë një filli, shpjeguam për nxënësit konceptin e veprimit dhe kundërveprimit.

22 prill 2024, orë mjedisore

Në kuadër të Ditës Botërore të planetit Tokë, AdZM Berat zhvilloi një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasës së 7-të dhe klasës së 8-të në shkollën 9-vjeçare "Faslli Saliaj" Vodicë. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me rëndësinë e planetit dhe problematikat me të cilat ne sot përballemi. Nxënësit kuptuan mbi përgjegjësinë që ka secili prej nesh në mënyrën e jetesës dhe sesi ajo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e planetit Tokë. Ora mjedisore u përmyll me mesazhe dhe vizatime sensibilizuese për ruajtjen e planetit tonë

pasoja negative eksperiment veprim dhe kundërveprim
mënyrë jetese



“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



16 prill 2024, me nxënësit e shkollës së mesme "Shefqet Guzi"

Specialistët e AdZM-së Elbasan, në bashkëpunim me bashkinë Gramsh, organizatën Eco Albania dhe nxënësit e shkollës së mesme "Shefqet Guzi", realizuan një guidë turistike në Gramsh, me rastin e çeljes së sezonit turistik. Përshkruam shtegun që të çon tek ujëvara, përgjatë të cilit eksploruam biodiversitetin e florës dhe faunës së kësaj zone. Korridoret ekologjike që zona paraqet diktojnë që ajo të promovohet dhe mbrohet për jetën e egër dhe trashëgiminë natyrore. Në këtë udhëtim mbreslënës bashkë me ne ishin edhe përfaqësues të mediave, me qëllimin e mirë të promovimit të zonës për dashamirësit e natyrës.

18 prill 2024, Dita Botërore e Trashëgimisë

Në kuadër të Ditës Botërore të Trashëgimisë, specialistët e AdZM-së Elbasan, realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ali Hana" Rrajcë, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Nxënësit u njohën me pasuritë natyrore dhe kulturore të parkut të cilat kanë vlera të mëdha. Parku i kësaj zone është një pyll i vjetër i ahut (*Fagus sylvatica*), i cili gëzon statusin e mbrojtjes nga UNESCO. Ora mjedisore u realizua në formën e bashkëbisedimit me nxënësit, të cilët herë pas here pyesnin ose jepnin mendimin e tyre rreth temës. Të kujdesemi për parkun dhe pasuritë tona natyrore, duke dhënë kontributin tonë në mbajtjen pastër të mjedisit, ishte mesazhi i përçaruar tek nxënësit gjatë kësaj ore mjedisore.

monumente natyre

ndërgjegjësim

flora dhe fauna

vlera natyrore

edukim mjedisor

hapsira të gjelbra

zona të mbrojtura

trashëgimi botërore

dita e tokës



22 mars 2024, Dita e Tokës

Në kuadër të Ditës së Tokës, specialistët tanë realizuan një aktivitet mjedisor, duke mbjell fidanë të llojit dushk (Quercus sp) dhe bredh i bardhë (Abies alba), në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Kasem Zika" Lunik, në afërsi të Parkut Kombëtar "Shebenik". Nxënësit mësuan rreth problematikave që sjell prerja masive e pyjeve dhe shpyllëzimi, si dhe rëndësinë që ka kontributi i secilit prej nesh në mbjelljen e fidanëve të rinj, për të ruajtur ekuilibrat ndërmjet rigjenerimit dhe përdorimit të pyjeve. Nisma të tilla shërbejnë për të edukuar dhe ndërgjegjësuar brezin e ri, si dhe për të përçuar tek ta dashurinë dhe dëshirën për të mbrojtur natyrën dhe pyjet.

23 mars 2024, njohim RNM "Dardhë-Xhyrë"

Realizuar një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Shaban Leka" Xhyrë, për t'u njohur me vlerat natyrore dhe mjedisore të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Dardhë-Xhyrë" florën dhe faunën e kësaj zone të mbrojtur. Ora u realizua në formën e bashkëbisedimit me nxënësit duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe e përshtatur atë sipas moshës së fëmijëve. Orët mjedisore kanë si qëllim përçimin e njohjes, promovimit të vlerave e bukurive natyrore dhe mbi të gjitha përçimin e dashurisë për natyrën tek brezat e rinj.

24 mars 2024, me nxënësit pranë RNM "Polis"

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Spathar", në afërsi të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Polis". Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Polis", me florën dhe faunën e kësaj zone të mbrojtur. Të kujdesemi për natyrën dhe zonat e mbrojtura ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Spathar", nëpërmjet kësaj ore mjedisore.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



03 prill 2024, me nxënësit e shkollës "Dhimitër Mino"

Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të Bashkuar "Dhimitër Mino", Lushnje. Gjatë kësaj ore mjedisore nxënësit u njohën me zonat e mbrojtura në qarkun Fier dhe speciet bimore e shtazore më të përhapura në këto zona. Me nxënësit diskutuam mbi rëndësinë e shpalljeve të zonave të mbrojtura dhe arsyet që duhet t'i ruajmë këto zona.

06 prill 2024, sport në natyrë

Parku Kombëtar "Divjakë-Karavasta" gjithmonë vizitohet prej vizitorëve nga vende dhe moshë të ndryshme. Këtë herë vizitorët zhvilluan sportin me kajak, pa krijuar shqetësim për faunën e egër. Fillimisht ata u këshilluan për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit nga stafi i AdZM-së Fier, si edhe u njohën me vende specifike për të cilat duhej të tregonin më tepër kujdes. Aktiviteti përfundoi me sukses, duke kaluar momente të këndshme dhe në harmoni me natyrën.

sport në natyrë eksplorim aktivitet ndërgjegjësues

shtigje burime natyrore konsumatorë



16 prill 2024, me nxënësit nga Vlora

Miq të shumtë të natyrës vizituan Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta në këtë ditë, ku ndër ta mund të veçojmë nxënësit e shkollës fillore "Rilindja" Vlorë. Në qendrën e vizitorëve nën kujdesin e specialistëve të AdZM-së Fier ata u informuan rreth Parkut Kombëtar "Divjakë-Karavasta", realizuan foto me pelikanin Xhon dhe më pas shijuan natyrën duke përshkuar shtigjet e parkut.

22 prill 2024, Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të Ditës Botërore të Tokës, AdZM Fier zhvilloi një aktivitet mbjellje në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar "Çermë-Sektor", Divjakë. Ky aktivitet shërben për të rritur ndërgjegjësimin e brezave të rinjë për mbrojtjen e Tokës dhe të burimeve natyrore.

22 prill 2024, eksplorim në natyrë

Studentë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, biologë dhe ekspertë mjedisi vizituan Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Pasi u njohën me vlerat natyrore në qendrën e vizitorëve, bashkë me stafin e AdZM-së Fier, grupi i vizitorëve vazhduan vizitën në terren, duke parë më nga afër bukuritë natyrore të parkut. Studentët mësuan gjithashtu për rregullat e parkut dhe mënyrat se si mund të zhvillojmë aktivitete në mënyrë sa më miqësore me mjedisin.

28 prill 2024, aktivitet pastrimi

Fundjava regjistroi një tjetër aktivitet ndërgjegjësues për pastrimin e Parkut Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Staf i AdZM-së Fier së bashku me grupin e Korpusit të Vullnetarëve ndërmori këtë aksion si një thirrje për të gjithë vizitorët, që të tregojnë kujdes përgjatë vizitave në park për të mos hedhur mbetje. Mbetjet janë një ndër problematikat më serioze në ditët e sotme për zonat e mbrojtura, pasi përtej faktit të ndotjes, aromave dhe pamjeve të pakëndshme, ato përdoren nga kafshët e zonës si ushqim, duke rrezikuar kështu jetën e tyre dhe atë të konsumatorëve.

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



15 prill 2024, Dita Botërore e Kafshëve Ujore

“Mbrojtja e mjedisit dhe reduktimi i rreziqeve natyrore” ishte tema të cilën AdZM Gjirokastrë zgjodhi për të diskutuar me klasën e 3-të të shkollës “1 Maji” në Përmet. Nxënësit mësuuan se fatkeqësitë natyrore mund të godasin në çdo moment dhe ashpërsia e tyre është shpeshherë e paparashikueshme. Ata mësuuan se cilat janë llojet e rreziqeve natyrore, vendet më tipike që janë prekur si edhe masat e menjëhershme që duhet të merren në rastet e ndodhive të rreziqeve natyrore.

19 prill 2024, mbrojtja e pyjeve nga zjarret

“Mbrojtja e pyjeve nga zjarri” ishte tema e cila AdZM Gjirokastrë realizoi në qendrën “Xhuzepe Grass”. Duke qenë se do të kemi rritje të temperaturave kemi filluar për sensibilizimin e të rinjve në shkolla, për të rritur vigjilencën dhe për të vepruar aktivisht kundër zjarrit.

22 prill 2024, njohim herbariumin e PK “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”

AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Koço Shukallari” në Përmet me temë “Herbariumi”. Nxënësit u njohën me herbariumin e PK “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”, rëndësinë e tij dhe vlerat që ai mbart.

22 prill 2024, çifti i lejlekëve në parkun e Viroit

Shpendët janë ndër krijesat thelbësore të ekosistemeve të zonave të mbrojtura, ndaj AdZM Gjirokastrë ka realizuar një orë edukimi mjedisor me vogëlushët e kopshtit “Xhuzepe Grass” në Gjirokastrë. Ndër të gjithë shpendët, fokusi ishte tek lejlekët, veçoritë e tyre fizike, habitatet ku ata jetojnë si dhe nga se rrezikohen ata. Fëmijët e vegjël u njohën me folenë e çiftit të lejlekëve, të cilët folezojnë pranë Parkut të Viroit.

sensibilizim fole lejlekësh fatkeqësi natyrore

herbarium lejlekët në parkun e Viroit

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË

09 16



09 prill 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM-së Vlorë realizuan një orë mjedisore për breshkat detare dhe jetesën e tyre, së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kafil Malaj” në Bishan. Është e rëndësishme që nxënësit të njihen jo vetëm me gjallesat tokësore por, edhe me ato detare, të cilat përballen me sfida të ndryshme që ndikojnë deri në zhdukjen e tyre. Veprimtari të ndryshme të pakontrolluara, të cilat çenojnë habitatet ku këto krijesa jetojnë, vijnë si rezultat i mungesës së ndërgjegjësimit tonë për kujdesin që duhet të tregojmë ndaj këtyre gjallesave ujore. Në përfundim nxënësit realizuan disa vizatime të breshkave detare.

16 prill 2024, Dita Botërore e Trashëgimisë

Me rastin e Ditës Botërore të Trashëgimisë, specialistët e AdZM-së Vlorë së bashku me nxënësit e shkollës Ekonomike “Antoni Athanas” në Sarandë realizuan një shteg mjedisor, për të njohur më nga afër pasuritë natyrore, arkeologjike dhe kulturore të Parkut Kombëtar të Butrintit. Në fokus të këtij aktiviteti ishin diskutime në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, biodiversitetit, turizmit të qëndrueshëm dhe asetet e shumëllojshme që ky park ka.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



3 prill 2024, Dita Botërore e Kafshëve Ujore

Në kuadër të kësaj dite me fëmijët e kopshtit nr. 5, klasa Bambi, grupi i tretë zhvilluam një aktivitet krijues, duke përdorur mjetet e nevojshme dhe imagjinatën. Së bashku krijuam një akvarium prej kartoni. Fëmijët ngjyrosën gjallesat ujore, i prenë me gërshërë dhe nëpërmjet një spangoje i vendosën në akvarium. Gjithashtu u zhvillua edhe një pyetësor mbi kafshët ujore, duke njohur kështu fëmijët me gjallesa të reja të botës nënujore.

16 prill 2024, vizitojmë shpellën e Trenit

Së bashku me nxënësit e shkollës “Raif Kolami”, në fshatin Tren zhvilluam një aktivitet informues për biodiversitetin në Parkun Kombëtar “Prespë” si dhe sfidat me të cilat përballen specie që rrezikojnë të zhduken. Duke vizituar më nga afër shpellën e Trenit dhe Parkun Kombëtar të Prespës, nxënësit arritën të identifikonin llojet që njohën nga specialistët tanë. Duke mësuar mbi rëndësinë e natyrës dhe të biodiversitetit e përmbyllëm aktivitetin me një aksion pastrimi, duke treguar përkujdesje për mjedisin përreth.

kafshë ujore

akvarium

shpella e Trenit

tingujt e lakuriqëve të natës

dedektorë tingujsh

nëna natyrë

17 prill 2024, Dita mbi vlerësimin e lakuriqëve

Në kuadër të kësaj dite, është zhvilluar një trajnim në mjediset e administratës në fshatin Goricë, me pjesëmarrjen e ekspertëve të AdZM-së Korçë, ekspertë të Parkut Kombëtar Galicica, PPNEA dhe nxënës të shkollës "Goricë", përkatësisht klasat e 8-ta dhe 9-ta. Për pjesëmarrësit u prezantuan të dhënat e viteve të fundit të numrit dhe kolonive të lakuriqëve. Ekspertët e PK Galicica prezantuan një pajisje e cila bën të mundur dedektimin e tingujve të lakuriqëve, si dhe përcollën disa këshilla për nxënësit; sesi të mos i dëmtojmë këto koloni prezente në park, për të cilët vendosëm edhe fole të ndërtuara prej druri, për të strehuar lakuriqët e natës.

22 prill 2024, Dita e Tokës

Së bashku me klasat e 9-ta të shkollës "Muharrem Çollaku" në Pogradec, u zhvillua një orë mjedisore për rëndësinë e planetit Tokë në jetën e gjithësecilit prej nesh. Ndamë këshilla për nxënësit, se si ne duhet të veprojmë për të ruajtur mjedisin. Prezantimi që paraqitëm u shoqërua me diskutime të frytshme mes nesh dhe nxënësve.

22 prill 2024, nëna natyrë dhuron për të gjithë

Specialistët e AdZM-së Korçë, së bashku me klasat e 7-ta të shkollës "Hamdi Alinj" në Pogradec, zhvilluan një aktivitet në kuadër të Ditës Botërore të Tokës. U zhvillua një prezantim dhe në fund të orës nxënësit dhanë mesazhe me mjaft vlerë për ruajtjen e nënës natyrë, që dhuron kënaqësi për të gjithë.